

VENDIM
Nr. 225, datë 20.12.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SA’GA-MAT” SHPK, PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 254, SERIA T14P, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERVE NR. 103, DATË 7.11.2014, PËR NJË AFAT 30-VJEÇAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 5, germa “dh”; nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.4.2017, nenit 18 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.119/10 prot., datë 18.12.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “SA’GA-MAT” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 254, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 103, datë 7.11.2014, për një afat 30-vjeçar.

konstatoi se:

- Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 103, datë 7.11.2014, ka licencuar shoqërinë “SA’GA-MAT” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.
- Shoqëria “SA’GA-MAT” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, nr. 748 prot., datë 14.11.2019, ka kërkuar heqjen e licencës nr. 254, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 103, datë 7.11.2014, për shkak se nuk ushtron veprimtarinë e “tregtimit të energjisë elektrike”, për të cilën është licencuar nga ERE.
- Shoqëria në shkresën e depozituar në ERE me nr. 748 prot., datë 14.11.2019, ka parashtruar argumentet lidhur me kërkesën për heqjen e licencës.
- Shoqëria “SA’GA-MAT” sh.p.k., ka depozituar në ERE kopje të licencës nr. 254, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Rezulton se shoqëria “SA’GA-MAT” sh.p.k., ka kryer pagesën e rregullimit, për vitin 2018, në pajtim me pikën 3.8 të kushteve të licencës, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me vendimin nr. 212, datë 18.12.2019, Bordi i ERE-s është shprehur “Mbi llogaritjen e pagesave rregullore për vitin 2019 nga të licencuarit”.
- Afati i kësaj licence në zbatim të vendimit nr. 103, datë 7.11.2014, përfundon në datën 17.4.2044.
- Kërkesa e shoqërisë “SA’GA-MAT” sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit mbështetet në parashikimet e nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në të cilin citohet se: ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit; si dhe nenit 5, germa “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, e cila parashikon se: “Licenca hiqet me kërkesë të të licencuarit”,
- Rregullorea për procedurat e heqjes së licencës në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, neni 7, paragrafi 2 përcakton se: “Në rast se nga i licencuarit është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje”.
- “Rregullorja për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, në nenin 9, germa “d” të saj, përcakton se: “...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe / ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje”.

- Në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, dhe legjislacioni në fuqi i sipërcituar, i jep ERE-s të drejtën ligjore për t’u shprehur me një vendim miratimi pa kaluar më parë në fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “SA’GA-MAT” sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 254, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 103, datë 7.11.2014.

2. Shoqëria “SA’GA-MAT” të shlyejë detyrimet e përcaktuara në vendimin e bordit të ERE-s nr. 212, datë 18.12.2019 brenda afatit të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas përmbushjes së kushtit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti